

STATUTI

I SHOQËRISË TREGTARE

"Amaltheia" SH.P.K

Shoqëria "Amaltheia" sh.p.k themelohet sot në datën 02.11.2020 në përputhje me Aktin e saj të Themelimit dhe përbëhet nga ortaku i mëposhtëm:

Bianka Selmanaj, me atësi Kahreman dhe amësi Selvije, dtl.09.07.1986, lindur në Kukës, dhe banues në Tiranë rruga "Petro Cani", Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria Tregtare "Amaltheia" sh.p.k, (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet ndërmjet ortakëve, funksionimin dhe kompetencat e organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare.

NENI 1

Objekti i veprimtarisë

1.1 Shoqëria ka si objekt veprimtaritë që vijojnë më poshtë:

Konsulencë tregtare dhe organizative në të gjitha format dhe në të gjithë sektorët e aktiviteteve brenda dhe jashtë vendit; projektim dhe realizim të programeve formuese dhe të zhvillimit të burimeve njerëzore; promovimi i aktiviteteve me karakter publicitar; projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nëpërmjet shfrytëzimit të të gjitha instrumentave, përfshirë marketingun telefonik dhe instrumentave të tjera të marketingut të drejtpërdrejtë; shërbime marketingu brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet telefonit dhe internetit;

Mbledhja, e perpunimi e menaxhimi i të dhënave, realizimi i sondazheve e studimeve të ndryshme. Krijimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i faqeve të internetit për të tretë, përfshirë shoqëri tregtare vendase dhe të huaja. Konsulencë dhe trajnime teknologjike, projektim dhe zbatim sistemesh teknologjike, Shitje-Blerje pajisje të ndryshme IT.

Shërbime publicitare në fushën e reklamave Radio-Televizive, punimeve grafike, studjo pikturë e tjera. Shërbime të ndryshme, në favor të të tretëve, si konsulencë, shërbime në fushën administrative.

Zhvillim software, në të gjitha platformat për web, desktop, mobile etj duke përfshirë proceset e analizës, dezajn, planifikim, implementim, mirëmbajtje, telemarketing, investime në fushen e ndërtimit për ambjente tregëtare, kulturore ,sportive, banimi etj.

1.2 Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

NENI 2

Emri dhe selia e Shoqërisë

2.1 Shoqëria është Person Juridik Privat.

Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj "*Amaltheia*" sh.p.k, (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar).

2.2 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga "Ferit Xhajko", Ndërtesa nr. 36, njesia administrative nr. 8, Tiranë.

2.3 Shoqëria tregtare "*Amaltheia*" sh.p.k mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 3

Kohëzgjatja e Shoqërisë

3.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.

NENI 4

Regjimi Juridik i Shoqërisë

4.1 Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.

Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit së Themelimit, Statutit, si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve (Ortaku i Vetëm), Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi, si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

4.2 Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT

NENI 5

5.1 Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Shoqërisë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qira, me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme. (Ortakut të Vetëm).

NENI 6

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakut të Vetëm

6.1 Ortaku i Vetëm jep kontributin e tij në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut, në të cilën është përcaktuar në mënyrë të detajuar kontributi dhe mënyra e afatet e derdhjes së këtij kontributi në këtë shoqëri. Ortaku i Vetëm përgjigjet ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përbushja e tyre përtej afateve përkatëse. Ortaku i Vetëm mban përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

6.2 Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë Ortakun e Vetëm për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tij, duhet t'i vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.

6.3 Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë Ortakun e Vetëm për periudha një mujore dhe tremujore për ecurinë e shoqërisë, realizimin e objektivave mujore dhe tremujore, llogaritë, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare me partnerët nënkontraktorë, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.

6.4 Gjatë ushtrimit të të drejtave, Ortaku i Vetëm vepron duke marrë parasysh interesat e shoqërisë. Ortaku i Vetëm respekton detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ai përpiqet për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektivit të veprimtarisë së saj.

III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË

NENI 7

7.1 Veprimtaria e funksionimit të Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

NENI 8

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i Ortakut të Vetëm në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

- a) **Ortaku i Vetëm i Shoqërisë**, zotëron një kuotë me vlerë 100.000 lekë (njëqind mijë lekë), e cila përbën 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- b) Kontributet që përbëjnë 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë janë shlyer tërësisht nga Ortaku i Vetëm.

8.2 Ortaku i Vetëm, në bazë të kërkesës së organit administrues, mund të sjellë para në shoqëri. Kjo derdhje parash mund të bëhet në formën e zmadhimit të kapitalit ashtu si dhe në formën e financimit të shoqërisë. Në rastin e financimit të shoqërisë nga Ortaku i Vetëm në formë huaje, nuk është e nevojshme të respektohet përpjesëtuueshmëria mes shumës së derdhur në shoqëri dhe kuotave të kapitalit që Ortaku i Vetëm zotëron.

NENI 9

Pasuria e Shoqërisë

9.1 Shoqëria bëhet pronare e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme kur vlera e pasurisë mbulohet tërësisht në të holla.

NENI 10

Transferimi i kuotave

10.1 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka të drejtën të transferojnë lirisht kuotën që zotërojnë në kapitalin e regjistruar të shoqërisë, kundrejt pagesës së një shume;

10.2 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka të drejtë të heqë dorë nga Shoqëria dhe mund të shesë kuotën nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitjes së kuotës, pa qenë nevoja e marrjes së një vendimi paraprak nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë në përputhje me kushtet që i lejon Statuti dhe Ligji. Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron atë nga detyrimet që ka deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk e cenon atë në marrjen e të ardhurave që Shoqëria ka siguruar deri në këtë moment.

10.3 Kuotat e kapitalit mund të transferohen në mënyrë të lirë përmes dhurimit apo çdo akti tjetër, falas.

NENI 11

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

11.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm).

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke u vendosur rritja e vlerës së kuotës së Ortakut të Vetëm.

Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm), vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën, Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

NENI 12 **Fondet rezervë**

12.1 Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj.

NENI 13 **Bilanci**

13.1 Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakut të Vetëm ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me format e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

NENI 14 **Plani financiar**

14.1 Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë, të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

NENI 15 **Shpërndarja e fitimeve, kufizimi i shpërndarjes**

15.1 E ardhura neto që rezultojnë mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloji aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kredinë për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortaku i Vetëm, sipas qëllimeve të tij. Ortaku i Vetëm ka të drejtë të marrë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

15.2 Shoqëria mund të shpërndajë fitime, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.



IV. ORGANET E SHOQËRISË

NENI 16 Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm)

16.1 Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime për:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të Autorizuar;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare mujore, tremujore e vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- përcakton tagret e përfaqësimit të administratorëve në kushtet e nënshkrimit të kontratave të bashkëpunimit me shoqëri apo individë, kontratave të sipërmarrjes apo të shitjes, si dhe miraton kontratat tip që do të nënshkruhen.
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

NENI 17 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

17.1 Asambleja e Përgjithshme mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët apo Ortaku i Vetëm.

17.2 Vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm, se bashku me procesverbalin e mbledhjes dhe aktet e tjera që i bashkëlidhen sipas ligjit këtij procesverbalit, regjistrohen në librin e shoqërisë.

NENI 18 Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë

18.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbalëve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 19

19.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.

19.2 Mund të emërohen si administratorë të shoqërisë edhe personat fizikë që nuk janë Ortakë.

19.3 Emërimi i Administratorëve bëhet me unanimitet nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm).

NENI 20

Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve

20.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

1. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm);
2. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) për miratim;
5. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin "Për regjistrimin e biznesit";
7. raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

9. të bëjnë pagesa pa miratimin e Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) vetëm për likuidimin e pagave, sigurimeve shoqërore, detyrimet tatimore, shpenzimeve të drejtpërdrejta të aktivitetit të shoqërisë, lidhur me aktivitete të parashikuara nga buxheti i miratuar.
10. të bëjnë pagesat që i detyrohet subjektit ndërtues dhe nënkontraktorëve, konform situacionit të punimeve të paraqitur e të miratuar nga eksperti kontabël.
11. të nënshkruajnë kontratat e sipërmarrjes, të bashkëpunimit apo paraprake të shitjes për objektet që janë në ndërtim e sipër, sipas çmimeve paraprake të miratuara nga Ortaku i Vetëm për çdo komponent të ndërtimit të ri.

20.2 Përveç detyrave të treguara më lart për çdo veprim tjetër administratori/ët duhet të marrë më parë miratimin e Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetëm).

20.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm), mund të parashikojnë ndryshe.

20.4 Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë.

Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 21

Shpërblimi i administratorëve

21.1 Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetëm).

Shpërblimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

21.2 Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

21.3 Administrator i Shoqërisë " *A m a l t h e i a* " sh.p.k, do të jetë *Bianka Selmanaj*.

NENI 22

Ekspertët Kontabël

22.1 Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo vit financiar kur jemi përpara rasteve të përcaktuara në ligj. Emërimin e tyre e bën Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetëm).

Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë. Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesi, administratori, personat që janë gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt.

VI. MARRËDHËNIET E PUNËS

NENI 23

23.1 Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontratës individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve. Marrëdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

NENI 24

24.1 Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

VII. PRISHJA E SHOQËRISË. LIKUJDIMI

NENI 25

25.1 Kjo Shoqëri do të prishet në rast se:

1. me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetëm);
2. me hapjen e procedurave të falimentimit;
3. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar;
4. me vendim të gjykatës;
5. për arsye të tjera, të parashikuara në statut;

Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznosit nga administratorët.

NENI 26
Likuidimi i shoqërisë

26.1 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e afllësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm). Nëse Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

VIII. DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 27

27.1 Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 28

28.1 Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 29

29.1 Ky Statut përpilohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe, dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES

Bianka Selmanaj

Bianka Selmanaj

